

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Statista” SHPK**

**PRONËSIA, OBJEKTI, SELIA**

**Neni 1**  
**Ortaku i Vetëm**

- 1.1 Shoqëria **“Statista” SHPK** (**“Shoqëria”**) është themeluar në datën e dhënë në këtë Statut nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

**Z. Besmir Gjokuta**, shtetas shqiptar, lindur më 06.06.1986, në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I60606082T (në vijim referuar si **“Ortaku i Vetëm”**).

**Neni 2**  
**Emri**

- 2.1 Emri i Shoqërisë është **“Statista” SHPK**.
- 2.2 Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe botimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra për transmetim, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose pasohet nga sa vijon:
- i. fjalët *“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”* ose *“SHPK”*;
  - ii. numri unik i identifikimit (NUIS);
  - iii. kapitali themeltar dhe kapitali i paguar i Shoqërisë
  - iv. adresa e selisë; dhe
  - v. një shënim që Shoqëria është në likuidim, sipas rastit.

**Neni 3**  
**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është themeluar dhe organizuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 *“Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare”*, i ndryshuar (**“Ligji për Shoqëritë Tregtare”**).
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.



**Neni 4**  
**Bazat Ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe dispozitat e tjera të zbatueshme të ligjit shqiptar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e aktivitetit**

- 5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

**Neni 6**  
**Selia**

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në Njësia Bashkiake nr. 13, Rezidenca Kodra e Diellit nr. 2, nr. 193, Tiranë, Shqipëri.
- 6.2 Administratori mund të hapë ose të mbyllë në Shqipëri adresat dytësore të Shoqërisë.
- 6.3 Ortaku i Vetëm mund të hapë ose mbyllë agjenci, zyra përfaqësuese, degë që nuk kanë karakterin e adresave dytësore, si dhe të vendosë për çdo ndryshim të selisë.

**Neni 7**  
**Objekti**

- 7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitete në planifikim, zbatim projektsh dhe konsulencë në fushat e kërkimit të tregut, analizës statistikore, zhvillimit të studimeve hulumtuese cilësore dhe sasiore, marketingut, komunikimit, marrëdhënieve me publikun dhe median, promovimin, si dhe çdo veprimtari të lejuar me ligj.
- 7.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm

**Neni 8**  
**Kapitali**

- 8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë në datën e këtij Statuti është 100,00 lekë (njëqind lekë) dhe do të përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- 8.2 Ortaku i Vetëm zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit.



## **Neni 9**

### **Transferimi i kapitalit / Kufizimet në transferim**

- 9.1 Ortaku i Vetëm është pronari ekskluziv i të gjitha kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 9.2 Kuotat e kapitalit themeltar mund të transferohen, plotësisht ose pjesërisht, tek palët e treta vetëm me akt me shkrim.

## **Neni 10**

### **Zmadhimi i kapitalit**

- 10.1 Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kapitalin duke zmadhuar kontributin e tij në kapitalin themeltar me atë shumë dhe sipas atyre kushteve që përcaktohen në vendimin e Ortakut të Vetëm.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu me anë të nënshkrimit dhe pagimit të kuotave të reja të kapitalit nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

## **Neni 11**

### **Zvogëlimi i kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet në çdo mënyrë me vendim të Ortakut të Vetëm.

## **STRUKTURA E DREJTIMIT**

## **Neni 12**

### **Vendimet e Ortakut të Vetëm**

- 12.1 Vendimet kryesore lidhur me aktivitetin e Shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm, i cili është organi më i lartë drejtues i Shoqërisë. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen.
- 12.2 Mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të thirret nga çdo Administrator, ose nga Ortaku i Vetëm me postë të regjistruar ose postë elektronike të paktën shtatë ditë përpara. Për sa kohë Shoqëria ka vetëm një ortak dhe nëse vendoset kështu nga Ortaku i Vetëm, ky i fundit mund të heqë dorë nga formalitetet për thirrjen e mbledhjes dhe vendimet e asamblesë së përgjithshme mund të merren në një formë të shkruar, nënshkruar nga Ortaku i Vetëm dhe nuk kërkohet të mbahet asnjë procesverbal. Në rast të nevojitet një vendim urgjent, një miratim paraprak

elektronik (me e-mail) i Ortakut të Vetëm mund të paraprijë vendimin me shkrim të Ortakut të Vetëm, i cili hartohet më vonë dhe regjistrohet në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë.

12.3 Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të vendosë lidhur me çështjet e mëposhtme:

- a. modifikimet e këtij Statuti;
- b. pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotave);
- c. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- d. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidimin dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- e. të themelojë dhe/ose të mbyllë degë ose zyra përfaqësimi;
- f. të vendosë për përvetësimin dhe/ose në transferimin e kuotave në Shoqëri në Shqipëri apo jashtë saj;
- g. të mbikëqyre zbatimin e politikave tregtare nga administratori(ët) dhe nga çdo organ tjetër në Shoqëri;
- h. të miratojë pasqyrat financiare dhe bilancin vjetor, të përcaktojë buxhetin vjetor dhe të miratojë shpërndarjen e fitimeve dhe/ose përballimin e humbjeve;
- i. të emërojë ose shkarkojë administratorin (ët);
- j. të miratojë rregullat e brendshme të administrimit;
- k. të ngrejë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- l. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pronat dhe pasuritë e tjera paluajtshme;
- m. të përcaktojë pagën e administratorit(ëve);
- n. të vendosë për emërimin e ekspertëve kontabël;
- o. të përcaktojë organizimin administrativ dhe strukturor të Shoqërisë;
- p. të vendosë për çdo çështje tjetër zgjidhja e të cilës është në kompetencën e ortakëve sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe/ose sipas këtij Statuti.

### Neni 13

#### Administratori

- 13.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do t'i caktohet një ose më shumë administratorëve ("Administratori") të emëruar dhe zëvendësuar nga Ortaku i Vetëm. Drejtori i një shoqërie mëmë nuk mund të emërohet si Administrator i një filiali dhe anasjelltas.
- 13.2 Administratorët mund të rizgjidhen.
- 13.3 Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe do të miratojë të gjitha vendimet që ai mund t'i konsiderojë të përshtatshme për të arritur dhe zbatuar objektin e shoqërisë, si dhe do të përfaqësojë individualisht Shoqërinë gjatë veprimtarisë të saj tregtare të përditshme dhe të zakonshme, përveç veprimeve ose çështjeve

të rezervuara ose për tu kryer bashkërisht me një person ose organ tjetër në përputhje me këtë Statut ose vendimet e Ortakut të Vetëm të miratuara kohë pas kohe.

- 13.4 Përveçse kur një çështje i rezervohet Ortakut të Vetëm sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij Statuti, Administratori do të ketë kompetenca individualisht për aktivitetet e mëposhtme:
- a. Të administrojë biznesin e përditshëm të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm.
  - b. Të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt palëve të treta dhe autoriteteve publike.
  - c. Të hapë, operojë dhe mbyllë llogaritë bankare të Shoqërisë.
  - d. Të lidhë marrëveshje dhe kryejë transaksione me palë të treta;
  - e. Të lëshojë fatura, kërkojë ose kryejë pagesa dhe pranojë letra me vlerë nga palët e treta;
  - f. Të punësojë dhe shkarkojë stafin e Shoqërisë dhe përcaktojë pagat, përfitimet dhe shpërblimet e tyre;
  - g. Të mbajë librat e kontabilitetit siç përcaktohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit;
  - h. Të përgatisë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë dhe të kryejë auditimin e tyre nga auditues të jashtëm nëse kërkohet nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm;
  - i. Të kryejë veprime të tjera në lidhje me veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.
- 13.5 Administratori mund të delegojë pjesërisht të drejtat e tij tek një palë e tretë me autorizim të vulosur me vulën e Shoqërisë (autorizim specifik).
- 13.6 Administratori do të ketë mandat për një periudhë që nuk i kalon 5 (pesë) vjet, mandati i tij mund të rinovohet, përveç nëse revokohet dhe zëvendësohet më herët për çdo shkak me vendim të Ortakut të Vetëm. Revokimi i Administratorit me vendim të Ortakut të Vetëm nuk do të interpretohet si një zgjidhje automatike e kontratës së tij nga Shoqëria, njoftimet përkatëse të kontratës, afatet kohore dhe shpërblimet e parashikuara në këto kontrata, nëse ka, duhet të respektohen dhe të përbëjnë shpërblim të drejtë dhe të plotë për çdo pretendim të Administratorit.
- 13.7 Administratori do t'i raportojë Ortakut të Vetëm.
- 13.8 Administratori i parë i Shoqërisë i emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare është:
- **Z. Besmir Gjokuta**, shtetas shqiptar, lindur më 06.06.1986, në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I60606082T.

**Neni 14**  
**Detyrat dhe Përgjegjësia e Administratorit**



- 14.1 Përveç detyrave të përcaktuara në Nenet 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori(ët) duhet:
- a. të përmbushin detyrat e tyre sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, këtij Statuti ose të përcaktuara me vendim të Ortakut të Vetëm në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit në mjedis të veprimtarisë të saj;
  - b. të ushtrojnë kompetencat e tyre të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut ose të përcaktuara me vendim të Ortakut të Vetëm, vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu;
  - c. të marrin në konsideratë çështjet që do të vendosen;
  - d. të parandalojnë dhe të shmangin konfliktet aktuale dhe të mundshme midis interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;
  - e. të kenë kujdesin e duhur që karakterizon një tregtar të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm dhe të respektojnë fshehtësinë në lidhje me çështjet konfidenciale;
  - f. të sigurojnë çdo informacion në lidhje me të dhënat e biznesit dhe ato ekonomike të kërkuara nga Ortaku i Vetëm brenda një kohe të arsyeshme dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të përditësohen.
- 14.2 Administratori(ët), gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, do të jenë përgjegjës ndaj Shoqërisë për një veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektin e Shoqërisë, përveç nëse, në vijim të hetimi dhe vlerësimit të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi ka qenë me mirëbesim.
- 14.3 Në rastin e shkeljes së detyrave dhe standardeve të kujdesit të duhur të referuar në paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 14, Administratori është i detyruar të kompensojë Shoqërinë për çdo dëm që rrjedh nga kjo shkelje. Gjithashtu, ai do të heqë dorë nga përfitimet personale të marra nga ai ose persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrave të tij. Ai do të ketë barrën e provës së pajtueshmërisë me detyrat e tij dhe standardet e kërkuara. Kur një shkelje është kryer nga më shumë se një person, të gjithë personat në fjalë do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçmas ndaj Shoqërisë.
- 14.4 Në veçanti, por jo vetëm, Administratorët janë të detyruar të kompensojnë Shoqërinë për dëmin e shkaktuar, nëse ata kryejnë në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut ose vendimet e Ortakut të Vetëm, transaksionet e mëposhtme:
- a. kthejnë kontributet;
  - b. paguajnë interesat ose dividendët;
  - c. shpërndajnë aktivet e Shoqërisë;
  - d. lejojnë shoqërinë që të kryejë veprimtari tregtare kur, sipas situatës së saj financiare, është parashikuar që ajo nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e saj;
  - e. japin hua.
- 14.5 Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për pretendimet sipas paragrafëve të mësipërm të këtij neni. Këto pretendime duhet të paraqiten brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes ose zbulimi i saj.

**Neni 15**  
**Audituesi(ët) ligjor**

- 15.1 Audituesi i jashtëm i Shoqërisë do të emërohet me vendim të ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme. Mandati i audituesit, në rast se do të emërohet një i tillë, duhet të rinovohet çdo vit.

**Neni 16**  
**Viti financiar**

- 16.1 Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

**Neni 17**  
**Pasqyrat Financiare. Kontabiliteti**

- 17.1 Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të shqyrtohen dhe miratohen nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të dorëzohen pranë autoriteteve tatimore para fundit të muajit mars të vitit pasardhës.
- 19.1 Librat e kontabilitetit duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të tjera në valutë të huaj, shuma të cilave duhet të konvertohen në monedhën vendase çdo muaj.

**Neni 18**  
**Likuidimi**

- 18.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë të prishë Shoqërinë dhe të caktojë një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.
- 18.2 Likuiduesi(ët) do të përgatisin raportin e likuidimit i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe dokumentet e tjera të likuidimit dhe do të miratojë përfundimin e procedurës së likuidimit.

**Neni 19**  
**Ndryshimet e Statutit**

- 19.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.



**Neni 20**  
**Dispozita përfundimtare**

20.1 Ky Statut është përgatitur dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më 09.03.2023 nga:

**PËR ORTAKUN E VETËM**

**Znj. Frensis Nakuçi**  
**Përfaqësuese me prokurë**

Frensis Nakuçi

